REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 10090/ Prot., Date 28 8 2012

MINISTRIA E SHENDETESISE
MINISTRI

Nr. 2436/4 Prot, Date 27/08/2012

# UDHEZIM

Nr 273/1 Date 27/08/2012

**"Per dokumentacionin dhe procedurat e dhenies me perparesi te pageses se demshperblimit per ish te denuarit politike dhe familjareve te tyre, qe vuajne nga semundje te renda"**

Ne mbeshtetje te nenit 102 te Kushtetutes, nenit 32, te ligjit Nr. 9831, date 12.11.2007, "Per demshperblimin e ish te Denuarve Politike te Regjimit Komunist", te ndryshuar dhe te germes "b", te pikes 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 419, date 14.04.2011 "Per miratimin e afateve dhe te Skemes se Shperndarjes se Fondeve te Demshperblimit per ish te Denuarit Politike te Regjimit" me qellim percaktimin e dokumentacionit dhe proceduravet te dhenies me perparesi te pageses se demshperblimit per ish te denuarit politike dhe familjareve te tyre, qe vuajne nga semundje te renda, Ministri i Financave dhe Ministri i Shendetesis:

## UDHEZOJME:

1. Per efekt te ketij vendimi, mund te perfitojne vetem persona te perfshire ne piken 3 te tij.

2. Dokumentacioni dhe procedura qe nevojiten per dhenien me perparesi te pageses se demshperblimit
per ish te denuarit politike nga regjimi komunist ose e familjareve te tyre, te cilet vuajne nga semundje te renda, do te jete per kategorite e meposhtme:

a) **Te denuarit politike ose familjaret e viktimave te cilet nga Komisioni Mjekesor i Caktimit te Aftesise per Pune (KMCAP) jane vleresuar me humbje te plote te aftesise per pune.**

Per te perfituar perparesi ne dhenien e pageses duhet te paraqitet:

- Vendimin e KMCAP i cili verteton humbjen e plote te aftesise per pune.
- Ky eshte dokumenti baze juridiko-mjekesor-administrativ qe njeh te drejten per perfitime sipas shkalles se humbjes se aftesise per pune.
- Dokumenti duhet te jete i plotesuar sakte sipas kerkesave te formatit, me shkrim te lexueshem pa korigjime.
- Dokumenti duhet te kete te shkruar emrin dhe mbiemrin e anetareve te KMCAP nenshkrimin e tyre si dhe me vulen e komisionit.

Procedura qe ndiqet eshte ajo qe ndiqet per paraqitjen ne KMCAP per perfitimin e pensionit per pune

..enti paraqitet ne zyren e ngarkuar, per dhenien e demshperblimit

n) <u>**Te denuarit politike ose familjaret e viktimave te cilet vuajne nga semundje malinje onkologjike ose hematologjike (semundje te gjakut).**</u>

Duke qene se patologjite onko-hematologjike trajtohen kryesisht ne spitalet universitare dokumenti
sipas semundjes do te leshohet vetem nga:

- Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza";
- Spitali Universitar i Semundjeve te Mushkerive "Shefqet Ndroqi";
- Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldine";
- Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Glozheni"

Perfituesi duhet te zoteroje:

- Nje epikrize te leshuar nga sherbimet perkatese ne institucionet universitare te sipercituara ku te pershkruhet diagnoza dhe stadi i semundjes.
- Kjo epikrize pergatitet nga mjeku qe trajton te semurin, sipas specialiteteve dhe nenshkruhet me emer e mbiemrin e mjekut kurues.
- Shefi i sherbimit duhet te vertetoje saktesine e diagnozes dhe ta nenshkruaje kete dokument.
- Se fundi epikriza firmoset nga drejtuesi i institucionit shendetesor me vulen perkatese

  Perfituesit per tu paisur me dokumentin e sipercituar duhet te zbatojne sistemin e referimit ne sherbimin shendetesor:

- Te paraqitet te mjeku i familjes, me nje vertetim te leshuar nga zyra perkatese e Komitetit Shteteror te te Perndjekurve Politike. i cili verteton se personi perfshihet ne piken 3 te vendimit.
- Mjeku i familjes e referon te semurin tek specialisti perkates.
- Mjeku specialist, sipas semundjes e referon te semurin ne sherbimet perkatese te institucioneve universitare te Tiranes.
- Dokumenti paraqitet ne zyren e ngarkuar, per dhenien e demshperblimit
- Institucionet e ngarkuara ne kete udhezim qe do te plotesojne dokumentacionin per efekt te ketij udhezimi, ta shprehin ne gjuhe te kuptueshme nga administrata qe do te zbatoje udhezimin.

**MINISTER I FINANCAVE**

**Ridvan BODE**

**MINISTER I SHENDETESISE**

**Vangjel TAVO**